



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE

*Bajram Curri 15.05.2018*

## **Njoftim për Dëgjësë Publike**

**Qëllimi i takimit: Dëgjësë Publike “Për prezantimin e Draft Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”**

**Të nderuar qytetarë!**

Në kuadër të përgatitjes për hartimin e buxhetit afatmesëm 2019-2021, Bashkia Tropoje ju fton të jeni pjesë e informimit dhe e konsultimit publik. Qëllimi i këtij takimi është të bashkërendojë punën dhe të përfshijë komunitetin në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm duke diskutuar mbi investimet për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe projekteve prioritare të Bashkisë në këtë hark kohor.

Takimi do të organizohet ditën e enjte më datë 24.05.2018, ora 11 në sallën e Keshillit , pranë Bashkisë.

Bashkia për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, Paketës Fiskale, Buxhetit Vjetor dhe Instrumentit të Planifikimit Financiar asistohet nga Instituti i Kërkimeve Urbane (URI), nëpërmjet mbështetjes financiare të dldp-së (Decentralization and Local Development Programme).

Pjesëmarrja juaj në takim është mjaft e rëndësishme, jeni të mirëpritur për të shprehur opinionin tuaj.

Me respekt,  
Kryetari  
Besnik Dushaj